



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Buletini Nr.1



Mbështetje për
Organizatat e Shoqërisë
Civile
për të zhvilluar
Ndërmarrje
Sociale

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti në zbatim **"Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile për të zhvilluar Ndërmarrje Sociale"**, financohet nga fonde të Bashkimit Evropian.

Organizata udhëheqëse për zbatimin e Projektit është Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë, në bashkëpunim me organizatën partnere, Agjencinë Rajonale të Zhvillimit Tiranë.

Ky projekt ka për qëllim të inkurajojë dhe mbështesë Organizatat e Shoqërisë Civile, të interesuara për të hapur apo fuqizuar Ndërmarrje Sociale.

Projekti parashikon mbështetje për përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor për ndërmarrjet Sociale, si dhe promovimin e ligjit tek organizata të interesuara për të hapur Ndërmarrje Sociale.

Dy tryeza konsultimesh mbi Ligjin dhe aktet e tjera nënligjore të aprovuara së fundmi nga Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë parashikuar për tu zhvilluar dhe rekomandimet do t'i përcillen Ministrisë përkatëse.

Një studim në terren për mundësitë që ofrohen për Organizatat e Shoqërisë

Civile për të ngritur ndërmarrje Sociale, si dhe kapacitetet ekzistuese për të menaxhuar këtë Ndërmarrje është në fazën e zbatimit.

Projekti synon të mbështesë në drejtim të ngritjes së kapaciteteve për planifikimin e biznesit të Ndërmarrjes Sociale, duke realizuar trajnime në disa rrethe të Shqipërisë.

Në formën e një thirrje të hapur, organizatat e shoqërisë civile që kanë ide për fillimin e një Ndërmarrjeje Sociale apo edhe zhvillimin e saj do thirren për të aplikuar dhe përfituar nga grante të vogla.

Organizatrat që do të përfitojnë grantin do të vazhdojnë të mbështeten në fazën e pare fillestare të zhvillimit me ngritje kapacitetesh për zbatimin e planit të biznesit, si dhe përmirësimin e aftësive për menaxhimin strategjik, organizativ, financiar dhe burimeve, duke siguruar kështu qëndrueshmërinë e investimit.

Projekti është parashikuar të zgjatë për 30 muaj, duke filluar nga Prill 2018 deri në Shtator 2020. Fondi prej 77,000 Euro do të shpërndahet në formë granti organizatave që do të paraqesin idetë më të mira për të krijuar dhe zhvilluar Ndërmarrje Sociale.

PERMBAJTJA

Përshkrimi i Projektit	1
Veprimtari të Projektit	2
Kuadri Ligjor i Ndërmarrjeve Sociale	3
Thirrje për shprehje interesi	4
Partnerët e Projektit	4

[Informacion më të detajuar mbi Projektin do të gjeni në:](#)

[Website dhe Mediat Sociale](#)

<http://www.ccp.al>
<http://www.rdatirana.al>

[www.facebook.com/
SocialEnterprises-CSOs](http://www.facebook.com/SocialEnterprises-CSOs)

"Ky material komunikimi reflekton vetëm pikëpamjet e autorëve dhe Bashkimi Evropian nuk është përgjegjës për përdorimin e përmbajtjes së këtij informacioni"

VEPRIMTARI PËR HAPJEN E PROJEKTIT



Projekti **“Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile për të zhvilluar ndërmarrje Sociale në Shqipëri”** organizoi veprimtarinë e hapjes e Projektit me datë 6 Qershor 2018, në Hotel Tirana International. Në këtë veprimtari morën pjesë rreth 60 pjesëmarrës nga Organizatat e Shoqërisë Civile të interesuara për Ndërmarrjet Sociale, përfaqësuesi i Delegacionit Evropian në Tiranë z. Enzo Damiani, përfaqësuesja e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Znj. Denada Seferi, etj.

Në panelin e parë, pas përshëndetjes nga Znj. Alida Kondi, drejtuese e Organizatës Qendra për Promovimin e Konkurrushmerisë, foli Z. Enzo Damiani, i cili bëri një pasqyrë të situatës së Ndërmarrjeve Sociale në Evropë dhe mbështetjen që Bashkimi Evropian po jepte për zhvillimin e Ndërmarrjeve Sociale edhe në Shqipëri.

Znj. Alida Kondi prezantoi objektivat e projektit, veprimtaritë që parashikohen të realizohen dhe rezultatet e pritshme nga Projekti. Në takim përshëndeti edhe Z Ilir Rëmbeci, nga organizata partnere për zbatimin e Projektit.

Në panelin e dytë, me interes u ndoq fjala e përfaqësueses së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Znj. Denada Seferi, që bëri një pasqyrë të situatës në lidhje me draftimin apo aprovimin e akteve nënligjore në zbatimin të ligjit.

Të ftuar në takim, Znj. Erisa Çela nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Gratë, prezantoi punën që po bëhet edhe nga Programi i tyre për draftimin e akteve nënligjore. Ndërsa përfaqësuesja e organizatës Partners Shqipëri, prezantoi Projektin që edhe organizata e tyre po zbatonte në mbështetje të ekonomisë sociale. Në takim folën edhe përfaqësues nga organizata të tjera që punojnë në mbështetje të Ndërmarrjeve Sociale. Takimi u mbyll me pyetje dhe përgjigje nga të ftuarit në takim, që kërkonin sqarime dhe detaje të mëtejshme.



TAKIM KONSULTATIV PËR LIGJIN E NDËRMARRJEVE SOCIALE

Takimi i parë konsultativ me organizatat e shoqërisë civile për kuadrin ligjor të ndërmarrjeve Sociale u organizua me datë 25 Tetor 2018 në qytetin e Vlorës, mbajtur në mjediset e Qendrës Rinore. Në këtë veprimtari morën pjesë rreth 30 pjesëmarrës

nga organizata të qytetit të Vlorës edhe Fierit. Pas përshëndetjes së Z. Ilir Rëmbeci, u mbajt një prezantim i shkurtër nga Znj. Alida Kondi, drejtore e projektit, për përfitimet e pritshme nga ky projekt, veçanërisht për mundësinë e përfitimit të granteve për organizatat që duan të krijojnë Ndërmarrje Sociale. Eksperti i projektit, Z. Bashkim Sykja, shpjegoi konceptin e Ndërmarrjes Sociale, që nga kriteret e qeverisjes;

shkalla e autonomisë; fuqia vendim-marrëse; pronësia; kriteri ekonomik; kriteri social; kufizim në shpërndarjen e fitimit; burimet e financimit; pjesëmarrja në prokurime publike; statusi i ndërmarrjes sociale, etj. Një shpjegim i detajuar u dha mbi aktet e tjera nën-ligjore, të cilat janë aprovur kohën e fundit nga Qeveria Shqiptare. Takimi u ndoq me shumë interes, pasi pjesëmarrësit kishin njohje të pakët të Ligjit. Disa nga pjesëmarrësit diskutuan dhe u sqaruan në lidhje me mundësinë që nëse idetë e tyre, të mund të fillonin të zbatoheshin apo të konvertoheshin në Ndërmarrje Sociale.



LIGJI Nr.65/2016 PËR NDËRMARRJET SOCIALE

Ligji Nr.65/2016, "Për Ndërmarrjet Sociale" u jep të drejtën Organizatave jofitimprurese të krijojnë ndërmarrje sociale.

Ndërmarrjet Sociale janë një model i ri biznesi, që prodhojnë mallra dhe shërbime për tregun, në ndjekje të qëllimeve sociale dhe mjedisore jofitimprurese.

Ndërmarrja Sociale e krijuar në formën juridike të një organizate jofitimprurese është formë e re e zhvillimit që të ndihmojë vetë organizatat për të siguruar një stabilitet më të qëndrueshëm

financiar në shërbim të misionit të tyre social në ndihmë të shtresave të pafavorizuara.

Ligji përcakton Kriteret Ekonomike dhe Sociale për tu konsideruar Ndërmarrje sociale.

Kriteret ekonomike kërkojnë që Ndërmarrja sociale të ushtrojë (i) veprimtari të vazhdueshme në fushën e prodhimit të mallrave ose ofrimit të shërbimeve, ku 20% e të ardhurave, pas vitit të dytë dhe 30% e të ardhurave, pas vitit të tretë, të realizohen nga veprimtaritë e parashikuara me ligj. (ii) ndërmarrjet duhet të përfshijnë të paktën, 3 (tre) punonjës me pagesë.

(iii) Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria ekonomike të shërbejë për zgjerimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së tyre.

Sipas Kriteve Sociale, Ndërmarrja sociale duhet të synojë nxitjen e objektivave sociale, pasi 30% e të punësuarve në ndërmarrjen sociale duhet t'i përkasin kategorive të grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike. Kategoritë konkrete të grupeve të grupeve të pafavorizuara përcaktohen në VKM-në nr. 56, datë 31.1. 2018.

AKTET NËNLIGJORE PËR NDËRMARRJET SOCIALE

Neni 5	pika 3	Miratimi i Manualit "Për promovimin e zhvillimin e Ndërmarrjeve Sociale" – dërguar për publikim
Neni 10	pika 2	VKM nr.16, datë 12.01.2018 "Për miratimin e listës së veprimtarive që ushtrojnë Ndërmarrjet Sociale"
Neni 11	pika 3	VKM nr.56, datë 31.1. 2018 "Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara"
Neni 13	pika 3	Udhëzim nr.607, datë 01.08.2018 "Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjes"
Neni 15	pika 2	Udhëzim i ministrit lidhur me përmbajtjen e regjistrimit të ndërmarrjeve sociale;- nuk është përgatitur
Neni 16	pika 2	Urdhër nr.636, datë 3.09.2018 "Për miratimin e rregullores tip të funksionimit të Ndërmarrjes Sociale"

STATUSI I NDËRMARRJEVE SOCIALE

1. Proçedura e marrjes së statusit të ndërmarrjes sociale:

- Udhëzimi nr. 607, datë 01.08.2018*
- a. Iniciativa merret nga vetë organizata jofitimprurëse me anë të një kërkesë drejtuar Ministrisë përgjegjëse për çështjet.
- b. Kërkesa duhet të paraqitet në formë të shkruar dhe të përmbajë (i) një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së organizatës, (ii) parashtrim të arsyeve se si organizata përmbush kriteret ekonomike dhe sociale të parashikuara në ligj për ndërmarrjet sociale.
- c. Kur një ndërmarrje sociale ushtron veprimtari për të cilat nevojitet licencë, pajisja me licencë, sipas përcaktimeve ligjore që rregullojnë licencimin, duhet të sigurohet.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të aplikuar për Ndërmarrje Sociale janë paraqitur më poshtë:

- a) Një vërtetim të lëshuar, jo më vonë se tre muaj para datës së aplikimit, nga Zyra e Regjistrimit të OJF-ve tek Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- b) Një kopje të statutit dhe aktit të themelimit;
- c) Një vendim të organit më të lartë vendimmarrës të organizatës jofitimprurëse ku të shprehet qëllimi i organizatës për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale;
- d) Dokumente të tjera që vërtetojnë përmbushjen e kriteve ekonomike e sociale;
- e) Kopje të licensës, nëse do të jetë rasti;
- f) Kopje të pasqyrave financiare të vitit paraardhës në rast se organizata e ushtron aktivitetin prej më shumë se një viti.

THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

Për Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) të interesuara për të marrë pjesë në programin e ngritjes së kapaciteteve për planifikimin e Biznesit të një Ndërmarrjeje Sociale

Në zbatim të këtij projekti, ka nisur identifikimi i organizatave të shoqërisë civile, të cilat tentojnë së shpejti hapjen apo fuqizimin e Ndërmarrjeve Sociale, apo planifikojnë të zhvillohen në këtë drejtim në të ardhmen. Fokus li veçantë do t'u kushtohet organizatave që punojnë pranë komuniteteve, grupeve të marginalizuara, grave apo të rinjve, personave në nevojë ekonomike apo sociale, në mbrojtje të mjedisit, dhe kulturës, si dhe organizatave që punojnë në zonat rurale, etj.

Mbështetja nga ana e Projektit do të jetë në ofrimin e trajnimeve për

përgatitjen e planit të biznesit, për organizatat që aspirojnë të orientojnë një pjesë të aktiviteteve të tyre në drejtim të krijimit të një veprimtarie të suksesshme ekonomike me focus social. Trajnimi do të japë gjithashtu njohuri dhe aftësi për menaxhimin dhe organizimin e ndërmarrjes, planifikimin e burimeve njerëzore, lëndët e para, klientët apo furnitorët.

Trajnimet do të organizohen në disa rrethe të Shqipërisë. Pastaj organizatat do të ftohen të aplikojnë për të përfituar nga grantet për të mbështetur fazën e parë të start-

upit të Ndërmarrjes Sociale. Organizatat pas përfitimit të grantit do të mbështeten nga ekspertë me këshillime në drejtim të organizimit, menaxhimit, çështjeve ligjore apo të regjistrimit për marrjen e statusit, në fazën e parë të fillimit të zbatimit të planit të biznesit.

Prandaj të gjitha organizatat e interesuara për të përfituar nga ky projekt janë të mirëpritura të shprehin dhe të ndajnë idetë e tyre me zbatuesit e projektit, për të përfituar sa më tepër nga munëditë që ofron projekti.

Na ndiqni ne faqen e projektit në facebook: SocialEnterprise-CSOs

ORGANIZATAT ZBATUESE TË PROJEKTIT



Adresa: Rr."Durrësit" P.7/1/1,
Tiranë -ALBANIA
E-mail: info@ccp.al;
Tel +355 692141920;
Web: www.ccp.al,
www.facebook.com/ccpalbania
Person Kontakti: Alida Kondi

Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë (CCP) është një organizatë jo-fitimprurëse, që ushtron veprimtarinë e saj që prej vitit 2011. Ajo ka fokusin kryesor në drejtim të ofrimit të mbështetjes për biznesin dhe zhvillimin e sipërmarrjes, nxitjen e start-up dhe zhvillimin e ekonomisë sociale. Organizata ka eksperiencë në menaxhimin e projekteve. Ajo ka eksperiencë të gjërë duke punuar me aktorët e biznesit, institucionet publike dhe donatorët në ofrimin e shërbimeve mbështetëse për biznesin, trajnime për kompanitë dhe të rinjtë sipërmarrës, kërkime tregu, studime dhe raporte dhe veprimtari promovuese.



Adresa: Rruga "Ismail Qemali" P
34/1, Ap3, Tirane
Tel & Fax: [04 254603](tel:+3554254603)/ [04 235704](tel:+3554235704),
e-mail: ilirrda@albmail.com
Person Kontakti: Ilir Rembeci

Agjencia Rajonale e Zhvillimit (ARZH) u themelua në vitin 1998. Misioni i saj kryesor është mbështetja e zhvillimit të sektorit të Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri. Me mbi 20 vite përvojë, ARZH ka përbushur detyra të rëndësishme duke kontribuar me punë pranë komunitetit lokal të biznesit, kontribuesve ndërkombëtare, autoriteteve qendrore e lokale si dhe OJQ-ve për të përmirësuar klimën e biznesit dhe inkurajuar zhvillim ekonomik në rajon nëpërmjet implementimit të programeve të përbashkëta koordinuese, si dhe ka shërbyer si një qendër resurcesh kros-sektoriale. Organizata ofron trajnime, studime tregu, planifikime biznesi, nxitje të sipërmarrjes dhe menaxhime projektesh.